



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Nr Prot

Belsh më 29/02 / 2024

PROCES-VERBAL

I mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 29.02.2024 me 17 këshilltarë prezentë, në mbështetje të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar nëpërmjet formatit elektronik.

Janë prezent në mbledhje 17 këshilltarë:

1. Libeta Dragoti
2. Gezim Gjoshi
3. Bujar Blloku
4. Nexhip Elezi
5. Aurela Hysa
6. Erion Gjoshi
7. Sami Uruci
8. Kujtim Dervishi
9. Naime Ibrahimimi
10. Aurjola Bezati
11. Blerim Kujja
12. Nertila Uruci
13. Gazeli Hysa
14. Fadil Zdrava
15. Enkeleda Kullolli
16. Erjon Qafa
17. Ismail Paja

Hapet mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari i këshillit z.Kujtim Dervishi. Hidhet në miratim rendi i ditës dhe miratohet. Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës për vërtetimin e mandatit të anëtarit të këshillit për z.Erjon Qafa. Lexohet formula e betimit nga kryetari i këshillit dhe betohet z.Erjon Qafa si këshitar i këshillit bashkiak Belsh.

2.Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës,për miratimin e ndihmes ekonomike.Mbron Entela Dervishi,përgjegjëse e ndihmës ekonomike.

K. Dervishi: Hidhet në votim. Miratohet me 16 vota pro.

3. Diskutohet pika e 3-të e rendit të ditës për miratimin e kontratës midis IADSA dhe Bashkisë Belsh.Mbron Albert Hysa nga zyra e BE-së. Në mbledhje merr pjesë dhe kryetari i Bashkisë z.Arif Tafani.Diskutojnë këshilltarët Ismail Paja dhe Blerim Kuqja për sqarime të mëtejshme rreth kontratës.Diskutohet nga kryetari i Bashkisë që kulla aktuale në bashkëpunim me IADSA do të kthehet në një qendër informacioni dhe një muze i vogël në funksion të turizmit.

K.Dervishi: Hidhet për votim pika e 3-të ,miratohet me vota 15 pro dhe 2 kundër.

4. Kalohet në pikën 4 të rendit të ditës ,Për miratimin e komisioneve të këshillit të bashkisë.Diskutojnë kryetarët e grupeve për një marrëveshje.Propozohen komisionet me nga 3 veta.Hidhet në votim dhe **miratohet me 17 vota pro dhe asnjë kundër.**

5.Diskutohet pika e 5-të e rendit të ditës,Për miratimin e 2 pikave për vendosjen e 2 kioskave info point në administrimin e Green Belsh sh.a.Mbron administratori i Green Belsh z.Bledar Pepa. Propozon këshilltari Ismail Paja që të jetë vetëm një kioskë dhe jo 2 si në projekt.Hidhet në votim propozimi i këshilltarit Ismail Paja dhe nuk miratohet me shumicë votash.Propozon Nertila Uruci që të ketë orar më të kufizuar të parkingut me pagesë.Hidhet në votim propozimi dhe nuk miratohet me 3 vota pro dhe 14 kundër.
Hidhet në votim projekt vendimi dhe miratohet me 14 vota pro,1 abstenim dhe 2 kundër.

6.Diskutohet pika e 6-të e rendit të ditës, për miratimin e ndarjes së pasurive sipas planit të rilevimit.Mbron Anxhelina Liçi dhe Anxhela Dervishi.Këshilltari Ismail Paja pyet për sa vite jepen me qera pronat publike.Sqaron Kryetari i Bashkisë që jepen për 9.99 vjet ose më pak se 10 vjet.**Hidhet në votim Projekt vendimi dhe miratohet me 17 vota pro dhe asnjë kundër.**

7.Në mbledhje merr pjesë qytetari Flori Hysa ku kërkon hapje rrugë pas objektit që ka në pronësi,në territorin e shkollës 9-vjeçare Belsh dhe përkohësisht,me kusht që të rindërtojë me shpenzimet e veta murin e shkollës.**Hidhet në votim hapja e rrugës dhe miratohet me 17 vota pro.**

Mbyllet mbledhja e këshillit me 7 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri BEPA

